



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Nr. 02/ 241
Datë: 29.06.2018

Procesverbal

i mbledhjes së III (tretë për vitin 2018) të Komitetit për Politik dhe Financa

RENDITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/525 datë:12.04.2018 dhe marrja e vendimit për procedurë të mëtejme për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër, të hapësirave publike për vendosjen e reklamave në qytezën e Malishevës.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/594 datë:20.04.2018 për shqyrtimin e draft-Planit të Integritetit të Komunës së Malishevës për vitet 2018-2020.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/598 datë: 23.04.2018, për marrjen e vendimit në lidhje me miratimin e draft-dokumentit, Plani i veprimit për Transparencë në Komunën e Malishevës për vitin 2018.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit nr.01/649 datë:27.04.2018 i parashtruar nga Kryetari i Komunës për shpalljen në interes publik të pronave private, sipas Elaboratit të shpronësimit.(e përsëritur).
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/404 datë: 13.03.2018, e parashtruar nga zj.Servete Krasniqi nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (e përsëritur).
7. Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2017 (e përsëritur).
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor Janar-Dhjetor 2017, i Qendrës për Punë Sociale (e përsëritur).
9. Shqyrtimi i Planit të Punës për vitin 2018, i Qendrës për Punë Sociale (e përsëritur).
10. Shqyrtimi i Planit të Zyrës së Prokurimit Publik për vitin 2018 (e përsëritur).
11. Paraqitja e raportit nga Kryetari i Komunës për punësimet në Komunën e Malishevës me kontratë në vepër, sipas kërkesës së parashtruar nga Grupi i këshilltarëve të PDK-së.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.11/394 datë:20.04.2018, e parashtruar nga DKAE në Malishevë për të përkrahur financiarisht pagesën e tri pagave përcjellëse për personelin arsimor të cilët janë pensionuar në vitin 2015,2016,2017 dhe 2018, si dhe kërkesa nr.01/596 datë:20.04.2018, e parashtruar nga Menaxheri i personelit në KK.Malishevë, për të përkrahur financiarisht pagesë se tri pagave përcjellëse për zyrtaret e administratës të cilët janë pensionuar në vitin 2014 dhe 2018.
13. Debat mbi çështjet e barazisë gjinore në Institucionet publike të Komunës së Malishevës.
14. Shqyrtimi i zbatimit të Udhëzimit Administrativ nr.02/2016 për Aktivitetet Jashtëshkollore nga Gjimnazi “Hamdi Berisha” në Malishevë.
15. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/648 datë:27.04.2018 e parashtruar nga Sadik Bytyqi nga fshati Shkozë KK.Malishevë, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

16. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/38 datë:25.04.2018 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, kërkesë për bartjen e mjeteve (THV) nga viti fiskal 2016 dhe 2017 në vitin fiskal 2018.

17. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2018.

18. Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Mars 2018.

19. Formimi i Këshillit Organizativ për kremtimin e festës zyrtare, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, e cila do të mbahet me 16 Qershor 2018.

20. Shqyrtimi i kërkesave.

21. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë 21.05.2018 në orën 13:45

Morën pjesë 5 anëtarë të Komitetit, zyrtari nga Drejtoria e Gjeodezis, Kushtrim Krasniqi si dhe Zyra për Informim.

Rrahim Morina: Përshëndetje për të gjithë. Materialin besoj e keni marrë me kohë. Te gjitha pikat e mbledhjedhjeve të kaluara janë në këtë mbledhje, ashtu edhe jemi marr vesh që njëherë me ardh në KPF e pastaj me pa se çka të bëjmë më tutje. Na kanë ardh disa kërkesa dhe ju kam sjellë edhe juve sot këtu. Unë hapi debat rreth rendit të dites.

Alban Krasniqi: Kam një vërejtje tek pikat që sponsorizues është Kuvendi komunal në këtë rast Komuna, ata duhet të jenë prezent në mbledhje, fjala është për drejtorit përkatëse. Dokumentat po janë të mangët për me i trajtu problemet, përveç letrave duhet të jetë edhe ai që e ka sjellë dokumentin.

Rrahim Morina: Unë e kam shprenda Planin e Punës së Kuvendit të gjithë drejtorëve poashtu ju kam drejtu me kërkesa që nga data 1 deri me datën 10 të na përgjigjen për shkak që po duhet 7 ditë para me thirrë mbledhjen. Të gjithë drejtorët që sot kanë pika në këtë mbledhje kanë qenë të informuar 2 ditë përpara.

Hashim Vrenezi: Lidhur me këtë qështje dua të ndërlidhem, për mos me lënë ne hapsirë të ankeses tek asnjëri prej drejtorëve dhe stafit komunal rendin e dites bashkë materialin që kur të na vjen neve edhe atyre me ju shku ose vetëm rendi i dites dhe nese ndonjë pikë i prek ata munden me ardh në mbledhje.

Rrahim Morina: Ka ndodh që tek një drejtor 3 herë kam kërku plotësim të materialit por nuk na është përgjigjë po ashtu kam kërku edhe nga kryetari që të kërkojë nga drejtorët të jenë më përgjegjës. A ka dikush rreth rendit

Alban Krasniqi: Ligjerisht pika 5 është hedh posht dhe nuk mundet me e përsërit të njejten Unë kërkojë që pika e 5-të të hiqet nga rendi i dites.

Rajmonda Krasniqi: Disa nga pikat janë të përsëritura bile shumë herë, dhe kjo është shqetësuese se kur po shkojmë në Kuvend po na bëhen 27-28 pika të rendit kjo për shkak të mos përgjegjesis së drejtorëve. Nëse drejtorët nuk vijin në mbledhje ne do ti heqim pikat nga rendi i dites. Të ju drejtohem me ndonjë kërkesë me shkrim të ju kërkojmë seriozite dhe përgjegjësi nga drejtorët.

Alban Krasniqi: Pika e 5 nuk duhet të jetë në rend të dites për diskutim. Nuk ka kërkesë tjetër dhe nuk mund të përsëritet një qështje që ne e kemi votu që mos me kalu në mënyren se si ka ardh. Duhet me u ripërserit kërkesa. Nuk ceket minimumi qështja e kompensimit aty edhe pse unë i kam dhënë vërejtjet e mia. Jam kategorik që kjo mos me u diskutu në rend dite. Kjo nuk ka kalu ne nuk kemi modifikim, ne nuk kemi shtes tjetër dokument.

Hashim Vrenezi: Unë nuk jam për me hek prej rendit të dites. Ne mundemi me kërku çka të dojm edhe ata me na sjellë kur të vjen materiali për asamble. Nëse na plotësohen kërkesat tona dhe na sjellin material në asamble ne aty do të diskutojm. Nuk po më duket ide e mirë një investim kaq kapital me shty. Po më duket e arsyeshme me diskutu, dhe ta përcjellim në kuvend.

Alban Krasniqi: Kjo është një qasje jo e duhur, kur qështjet kaq të rëndësishme po kalojnë kaq lehtë. Projekti që është për qytetarët duhet që bashkë me qytetarët të vendosim. Kjo skic për 1 orë e bëjmë, kjo e tregon edhe më shumë jo seriozitetin. Neve nuk na ka ardh se cilat janë pronat private cilat janë publike, cilat kanë me u shpall zonë me interes. Kur është interes i qytetarëve dhe kur është interesi i madh këto dilema hiqen krejt.

Rrahim Morina: Kryetari nuk është duke e njoft KPF-në. Kam qenë në zyre te ai, jemi dakordu me hy vetëm pjesa e shpronsimit por kur duhet të hy kjo duhet të ndërrohet kërkesa. Ne do të kërkojmë që kërkesa të vjen e drejt, të hiqet pjesa që duhet të hiqet.

Po e hudhi në votim propozimin e Albanit kush jeni për?

Për: 1

Kundër: 2

Abstenime: 2

A jeni për këtë rend dite?

Për: 4

Kundër: 1

Abstenime: 0

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Hashim Vrenezi: Tek emri im është shenu Hashim Hoxha të përmirsohet të mbiemri të bëhet Vrenezi.

Rrahim Morina: Kush është për aprovim të procesverbalit?

Për: 5

Kundër: 0

Abstenim: 0

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr/01-525 dt,12-04-218 për marrjen e vendimit për procedurat e mëtejme për dhënjën në shfrytëzim afatshkurtër të hapsirave publike për vendosjen e reklamave ne qytezen e Malisheves

Alban Krasniqi: Si për qështjen e bazenit të Banjnës kur kemi kërku raport prap edhe për këtë është i nevojshëm raporti mbi të hyrat përse i përket shfrytëzimit të reklamave. Edhe në emer të

subjektit, një kërkesë ju kam bërë edhe Drejtoris së Shërbimeve Publike kush i shfrytëzon këto reklama, realisht janë shfrytëzu po fatkeqësisht janë shfrytëzu nga vet djali i kryetarit të NISMA-s përmes nënkontraktorëve të vet dhe janë shfrytëzu në mënyrë të paligjshme që sa vite. Me qfarë baze dojm me marr vendim me i dhënë në shfrytëzim, çfarë kushte kem me vendos. Ne nuk kemi raport bile as nuk e dijm me qfarë kontrate janë dhënë në shfrytëzim. Drejtori nuk është këtu me na informu që realisht do duhej të ishte prezent.

Hashim Vrenezi: Është dhënë një informacion që janë 288m² janë paraqit 10 vende ku janë të pozicionuara reklammat edhe nuk e di metrat katror të këtyre a i tejkalojn a janë minus. Këto informata nuk janë të mjaftueshme, neve na duhet një raport i detajuar i reklamave dhe cila është metra katrore e tyre ku përveq kësaj kisha kërku që me na sjellë kontratat 2014, 2015, 2016, 2017, kush i ka pas në shfrytëzim sa ka pagu për to që me pas ne një indikacion me mujt me caktu qmimin për m² qmimin më të lart e kur të plotësohen këto kritere kalon. Kërkoj të sillen raportit financiar, kontratat, raportit i metrave katror të saktësohen sakt reklammat jo vetem ato të mëdhat .

Rrahim Morina: Do ti drejtohem me shkrim drejtorit me na sjellë ato, nese na sillen në Kuvend hecim me pikë që jo, e largojmë nga rendi i dites. Kjo pikë u rekomandu për Kuvend.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/594 datë:20.04.2018 për shqyrtimin e draft-Planit të Integritetit të Komunës së Malishevës për vitet 2018-2020.

Komiteti këtë pikë, me 5 vota unanimisht e rekomandoi për Kuvend.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr 01/598 dt, 23-04-2018 për marrjen e vendimit në lidhje për miratimin e draft-dokumentit të planit të veprimit për transparenc në Komunën e Malishevës për vitin 2018

Izet Shala: Ne si grup ku kemi qenë 4 komuna e kemi parapar me bërë këtë draft-plan. Është punu bashkë me OSBE-në. Ana finale e kësaj ka qenë në Suharek. Janë disa objektiva që duhet të punohet shumë në informimin e qytetarëve. Malisheva për herë të parë po e bënë një draft-strategji dhe një plan. Në kemi kërku aty që zyra e informimit të mbaj vetë konferenca për shtyp të informoj qytetarin me gjitha mekanizmat dhe mjetet e komunikimit.

Hashim Vrenezi: Ne jemi për me përcjell në Kuvend. E kam shfletu, ka sene të mira aty sikur të ishin respektu është shumë mirë por kur kthehem në praktik se sa herë kërkojmë me pas një dokument që ta lejon ligji për qasje në dokumenta zyrtare edhe nuk e merr. Shpresoj që ka me pas përkrahje të gjithë neve por shumë më shumë kisha pas dëshirë me pas zbatim e jo me mbet veç një dokument në leter.

Alban Krasniqi: Nësë nuk është strategjia është Rregullorja për Transparenc që i parasheh mjaftë qartë detyrat që i ka komuna në raport me qytetarin. E shoh që në web faqë të komunës vendimet e vetme të kuvendit qka i hasi janë vendime të themelimit të komiteteve dhe komisioneve po nuk janë gjitha vendimet që kuvendi i merr. Nga dita që kryesuesi e nënshkruan një vendim jeni të obliguar me publiku. Unë kam me kerku edhe nga ju kryesues që secilin vendim që kuvendi e nxjerr me na dergu edhe neve me kopje sepse deri me tash as një vendim nuk e kem të shtypur.

Ne në kuvend do ti japim sugjerimet tona konkrete por çka presim është që ky plan të realizohet në praktik.

Rrahim Morina: Kam qenë pjesë e hartimit, me të vërtetë shumë bukur parashihen senet aty vetëm lypet zbatimi i saj.

A jeni për me rekomandu për Kuvend?
5 unanimitisht ishin për

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit nr.01/649 datë:27.04.2018 i parashtruar nga Kryetari i Komunës për shpalljen në interes publik të pronave private, sipas Elaboratit të shpronësimit.(e përsëritur).

Rrahim Morina: A mendoni që të kërkojmë planin e fizibilitetit, planin ideor, përputhshmërin me planin zhvillimor komunal, prezantimi i projektit me projektor si dhe a është e njoftuar Ministria e Planifikimit Hapsinor.

5 unanimitisht ishin për rekomandim në Kuvend me këto dokument shtes.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/404 datë: 13.03.2018, e parashtruar nga zj.Servete Krasniqi nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (e përsëritur).

Rrahim Morina: Kush jeni për rekomandim për kuvend?
5 unanimitisht ishin për.

7. Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2017 (e përsëritur).

Alban Krasniqi: Unë e kam një propozim. Ne po flisim për rendin e dites së KPF dhe unë po propozoj që pika e 7, 8, 9, 10, 12 të jenë prej pikave të para të mbledhjes së kuvendit. Pastaj të jetë edhe pika e PDK-së e parashtruar pas pikes së 12

Hashim Vrenezi: Nëse pajtoheni unë kisha kërku që pika e grupit tonë te jetë me në fillim sepse ata po dalin jashtë dhe nuk po mundemi me diskutu asgjë.

Rrahim Morina: Pasi këto pika janë të përsëritura a po pajtoheni që pika 7, 8, 9, 10, 11 të shkojnë për kuvend?
5 unanimitisht ishin për

12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.11/394 datë:20.04.2018, e parashtruar nga DKAE në Malishevë për të përkrahur financiarisht pagesën e tri pagave përcjellëse për personelin arsimor të cilët janë pensionuar në vitin 2015,2016,2017 dhe 2018, si dhe kërkesa nr.01/596 datë:20.04.2018, e parashtruar nga Menaxheri i personelit në KK.Malishevë, për të përkrahur financiarisht pagesë se tri pagave përcjellëse për zyrtaret e administratës të cilët janë pensionuar në vitin 2014 dhe 2018.

Rrahim Morina: Edhe pse drejtori nuk është këtu unë dua të ju jap një informacion. Për 5-6 hërë i kam thënë drejtorit po edhe kryetarit nëse doni me sjellë këtu duhet me pas pjesen financiare mirëpo nuk na janë përgjigje.

Rajmonda Krasniqi: Kur është shqyrtuar kjo çështje ka qënë zyratari Halim Hoti dhe ne i kemi paraqit kërkesat tona, është përpjekur të na përgjigjet dhe na ka thënë që do të vijin të kompletuara për mbledhjen tjetër. Edhe tjetra, është ndryshuar kjo si pikë e rendit të dites me sa shoh. Është komplikuar por jo kompletuar ashtu siç na ka premtuar Halim Hoti. Ne i kemi paraqit kërkesat tona. Ne çka kërkojmë nga drejtori të jetë prezent në Kuvend.

Alban Krasniqi: Është mirë që ti bëjmë kërkesat tona që janë procedurale para se me marr vendimin. Kjo shkon në kuvend, por unë jam parimisht me i trajtu gjitha kategorit.

Rrahim Morina: A mund të kërkojmë listen e punëtorve që dalin në pension për 3 paga percjellse, mbështetjen financiare nga cili kod doni me i marr mjetet e ne cilin doni me i qit. Këto dyja neve na duhen e asgje tjetër.

A jeni për rekomandim në kuvend?

5 unanimisht ishin për

13. Debat mbi çështjet e barazisë gjinore në Institucionet publike të Komunës së Malishevës.

Rrahim Morina: Është diskutu kjo pikë, a pajtoheni me rekomandu për kuvend?

5 unanimisht ishin për.

14. Shqyrtimi i zbatimit të Udhëzimit Administrativ nr.02/2016 për Aktivitetet Jashtëshkollore nga Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë.

Rrahim Morina: Unë këtu ja kisha shtu edhe shkollën Kujtim Krasniqi.

Rajmonda Krasniqi: Nuk e di sa kemi të drejt me kërku këtë pasi ajo shkollë është me agjension.

Alban Krasniqi: Sa e di unë drejtorja i ka përgjegjesit e veta sepse kjo është memorandum i mirëkuptimit. Nuk e ka marr agjensioni, vet se komuna i ka bart disa obligime, si p.sh punsimin e disa gjëra por jo edhe organizimin.

Rrahim Morina: A pajtoheni ta rekomandojm për kuvend dhe ta kërkojm edhe këtë list?

5 unanimisht ishin për.

15. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/648 datë:27.04.2018 e parashtruar nga Sadik Bytyqi nga fshati Shkozë KK.Malishevë, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Rrahim Morina: A jeni që ta rekomandojm për kuvend?

5 unanimisht ishin për

16. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/38 datë:25.04.2018 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, kërkesë për bartjen e mjeteve (THV) nga viti fiskal 2016 dhe 2017 në vitin fiskal 2018.

Rrahim Morina: A e përcjellim për kuvend?
Sunanimisht ishin për

17. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2018.

Alban Krasniqi: Ne do ti propozojm disa ndryshime në mbledhjen e kuvendit. Kisha kërku që çdo ndryshim që propozohet të votohen një nga një. Për një çështje që jemi dakordu, bizneset e mëdha me ju rrit taksën diku për 50% të vleres që e kanë pas në rregulloren e mëhershme. Edhe tek pompat e benzines ato që janë në rrugë magjistrale të kenë tjera taksa me ato që janë brenda fshatrave tjetër.

Rrahim Morina: A pajtoheni ta rekomandojm për kuvend?
Sunanimisht ishin për.

18. Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Mars 2018.

Rrahim Morina: A pajtoheni ta rekomandojm për kuvend?
Sunanimisht ishin për.

19. Formimi i Këshillit Organizativ për kremtimin e festës zyrtare, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, e cila do të mbahet me 16 Qershor 2018.

Rrahim Morina: Ne e kemi një formul, është Kryetari, Kryesuesi, Shefat e Grupet Parlamentare, një përfaqësues nga OJQ-të, Komandanti i Policis. Nëse pajtohemi e rekomandojm për kuvend.
Sunanimisht ishin për.

20. Miratimi i Draft- Planit të Veptimit të Komitetit për Arsim, Kultur, Rini dhe Sport për vitin 2018

Rrahim Morina: A pajtoheni ta rekomandojm për kuvend?
Sunanimisht ishin për.

21. Shqyrtimi i kërkesave.

Rrahim Morina: Me sa i kam pa aty janë të rrethkuara vetëm një pjesë është jasht.

Hashim Vrenezi: Kam marr informacion që drejtorja ka qenë në vendin e ngjarjes dhe i kanë pas disa probleme ku kanë pas edhe polic me vete. Përsoni në fjalë e ka zënë një pjesë publike. Ajo çka po më intereson me ditë nëse po dojnë me rrugullu rrugen pse e kanë lënë vetëm një pjesë pa e rregullu. Është pronë publike dhe një përson e ka zënë.

Kushtrim Krasniqi: Ne kemi qenë aty e kemi shpall ozurpus, më tuje nuk jemi kompetent.

Rrahim Morina: Po e përcjellim për kuvend. Kush jeni për?
5 unanimsisht ishin për.

Kërkesa e Remzi Limajt.
Komiteti me 5 vota unanime kërkesën e shtyn për sqarim më të tutjeshëm.

Kërkesa Financiare e Lulzim Krasniqi.
Përshak të mungesës së dokumentit të identifikimit Komiteti vendosi të shtyjë për më tutje me kërkesën që të na sjellin dokumentin.


Kërkesa e Nebih Mazrekut.
Me 5 vota unanime Komiteti e rekomandoi kërkesen për kuvend.

Kërkesa e Hisen Mazrekut.
Me 5 vota unanime Komiteti e rekomandoi kërkesen për kuvend.

Kërkesa e fundit është nga Kryetari i Qytezës së Malisheves Amrush Hoti.
Me 5 vota unanime Komiteti e rekomandoi për kuvend.

Ju faleminderit për pjesëmarrje!
Mbledhja përfundoi në orën 16:30

Procesmbajtësja
Marigona Hoti



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina

